Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Pikturë**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**1**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**6**
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë trajtohen parimet bazë të pikturës, teknikat dhe mjetet kryesore, duke përfshirë metodat themelore në pikturim. Nëpërmjet ushtrimeve praktike, studentët do të krijojnë natyra të qeta, portrete dhe peizazhe, duke zhvilluar aftësitë e tyre vizuale dhe krijuese. Lënda përfshin gjithashtu studimin e perspektivës, eksplorimin e stileve artistike dhe teknikat bashkëkohore, përfshirë edhe pikturën digjitale.Një pjesë e rëndësishme e lëndës është krijimtaria individuale, ku studentët do të punojnë mbi tema të lira, do të riprodhojnë vepra të njohura dhe do të zhvillojnë stilin e tyre artistik. Në përfundim, ata do të jenë në gjendje të përdorin me efikasitet ngjyrat, dritë-hijet dhe kompozicionin, duke realizuar vepra me vlera artistike dhe estetike.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë bazë në pikturë, që nga konceptet themelore deri te eksperimentimi me stile dhe teknika të ndryshme. Përmes ushtrimeve praktike, studentët do të zhvillojnë perceptimin vizual, ndjeshmërinë ndaj ngjyrave, dritës dhe kompozicionit, si dhe aftësinë për të realizuar vepra artistike me vlera estetike. Gjithashtu, lënda synon të nxisë krijimtarinë dhe shprehjen individuale të studentëve, duke u ofruar mundësinë të eksplorojnë pikturën tradicionale dhe bashkëkohore, përfshirë teknikat digjitale. Në fund të kursit, studentët do të jenë të aftë të përdorin me efikasitet materialet dhe teknikat e pikturës për të shprehur idetë dhe vizionin e tyre artistik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: • Aplikojnë parimet dhe teknikat bazë të pikturës, duke përdorur materiale të ndryshme. • Zbatojnë teorinë e ngjyrave dhe krijojnë kompozicione harmonike.

	• Eksperimentojnë me stile të ndryshme, nga realizmi tek arti abstrakt. • Zhvillojnë stilin dhe shprehjen personale nëpërmjet krijimtarisë së lirë. • Përdorin teknikat digjitale në pikturë. • Analizojnë dhe prezantojnë veprat e tyre, duke argumentuar vlerat artistike.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2	4
Punë praktike	3	15	45
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren	3	2	6
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	3	6	24
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	7	21
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj	3	2	6
Totali			**150**

Metodologjia e mësimëdhënies:	Mësimdhënia bazohet në kombinimin e ligjëratave interaktive, demonstrimeve praktike, ushtrimeve individuale dhe grupore, si dhe analizës kritike të veprave. Gjithashtu, përfshihen përdorimi i teknologjisë në pikturë dhe prezantimet artistike, duke nxitur kreativitetin, aftësitë teknike dhe zhvillimin e shprehjes personale të studentëve.
Metodat e vlerësimit:	**70% – Punime praktike** Realizimi i punëve, zhvillimi teknik dhe progresi individual. **10% – Prezantim** Paraqitja e konceptit dhe reflektimi mbi procesin krijues.

	20% – Provimi final Njohuritë teorike dhe aplikimi i tyre në praktikë. **Shkalla e notimit (0–100 pikë)** 0 –49 pikë – Notë jo kaluese 50–59 pikë – Nota 6 60–69 pikë – Nota 7 70–79 pikë – Nota 8 80–89 pikë – Nota 9 90–100 pikë – Nota 10
Literatura	
Literatura bazë:	Painting for the Absolute and Utter Beginner Paperback – August 18, 2009 by Claire Watson Garcia
Literatura shtesë:	Oil Painting for the Serious Beginner: Basic Lessons in Becoming a Good Painter Paperback – June 1, 1996 by Steve Allrich.
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java e parë:	• **Hyrje në Pikturë** *Prezentimi i lëndës, njohja e pikturës dhe rëndësia e saj në artet e aplikuara.*
Java e dytë:	• **Materialet dhe teknikat e pikturës** *Njohja me akrilik, vaj, akuarel, pastel dhe përdorimi i mjeteve bazë.*
Java e tretë:	• **Teoria e Ngjyrave dhe Paleta** *Ndarja e ngjyrave: primare, sekondare dhe terciarë: ngjyrat komplementare dhe harmonike*
***Java e katërt*:**	• **Gradacioni në pikturë** *Pikturimi i figurave gjeometrike në teknikën bardh e zi*
Java e pestë:	• **Natyrë e Qetë** *Studimi i formave të thjeshta dhe ndriçimit; ndërtimi i kompozicionit bazë dhe dritë-hijes*
Java e gjashtë:	• **Natyrë e Qetë ,Kompozicioni dhe Kombinimi i Ngjyrave** *Balanca vizuale në një pikturë*
Java e shtatë:	• **Studimi i figurës (kroki)** *Kapja e lëvizjes dhe formës përmes ushtrimeve të shpejta.*
Java e tetë:	• **Portreti** *Ndërtimi i proporcioneve dhe trajtimi i tipareve përmes ngjyrës dhe tonalitetit.*
Java e nëntë:	• **Kolokvium (Natyrë e qetë)** *Vlerësim i progresit teknik dhe kompozicional.*
Java e dhjetë:	• **Piktura aplikative (kolazh, mozaik, vitraji)**

	Eksplorimi i teknikave alternative dhe punë krijuese individuale ose grupore.
***Java e njëmbedhjetë*:**	• **Piktura abstrakte** *Studimi i formës, ngjyrës dhe linjës përmes dekonstruktimit të realitetit.*
***Java e dymbëdhjetë*:**	• **Projekt eksperimental – Flipbook** *Krijimi i një sekuence pikturash që gjenerojnë ndjesinë e lëvizjes.*
***Java e trembëdhjetë*:**	• **Temë e lirë** *Realizim individual bazuar në stilin dhe interesin personal.*
***Java e katërmbëdhjetë*:**	• **Reproduksion & Pikturë digjitale** *Analizë e një vepre të njohur dhe aplikim i teknikave bashkëkohore digjitale.*
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	• **Prezantim final** *Paraqitja dhe diskutimi kritik i projekteve përfundimtare.*
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studentët duhet të jenë të rregullt dhe aktivë në ligjërata, të pajisen me mjete të punës, të dorëzojnë punët brenda afateve dhe të ndjekin etikën akademike. Respekti ndaj kolegëve dhe mësimdhënësve, kujdesi për materialet dhe mjedisin e punës janë thelbësore për një ambient krijues dhe profesional.	